



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:087433

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05797194

KPPP.nr. 2182/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit me seli ë Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, kundër debitorit Pika e Karburanteve “Aliu Petrol” me numër unik identifikues 810633645 dhe seli në Suharekë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Miftar Qelaj, avokat nga Prizreni, duke vendosur sipas propozimit për kthim në gjendje të mëparshme dhe prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1024/19, i lejuar me datë 17.06.2019, nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 07.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. LEJOHET kthimi në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Përmbarimor P.nr. 1024/19, i lejuar me datë 17.06.2019, nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj.
- II. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Aliu Petrol” me numër unik identifikues 810633645 dhe seli në Suharekë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1024/19, i lejuar me datë 17.06.2019, nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj.
- III. Urdhri Përmbarimor P.nr. 1024/19, i lejuar me datë 17.06.2019, nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit mbi bazën e dokumentit përmbartimor – Vendimit me numër të protokollit 6161, të datës 01.08.2017, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 1024/19, të datës 17.06.2019, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 11,970.50, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, me datë 18.07.2019, ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme me arsyetim se urdhri mbi lejimin e përmbartimit nuk i është dorëzuar konform dispozitave ligjore dhe se urdhri në fjalë është pranuar nga personat të paautorizuar, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi në fletë kthesë. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të lejoj kthimin në gjendje të mëparshme dhe prapësimi i debitorit të trajtohet si i afatshëm.

Së bashku me kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme, debitori ka paraqitur edhe prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, duke theksuar se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit është përfshi në parashkrim. Me tej, ka shtuar se për të njëjtën çështje janë në zhvillim e sipër disa procedura gjyqësore ndërsa disa prej tyre veç kanë përfunduar dhe rrjedhimisht kemi të bëjmë me gjyqvarësi dhe çështje të gjykuar. Në fund, ka theksuar se vendimi mbi bazën e së cilit është iniciuar procedura përmbartimore është pa efekt juridik dhe kërkesa e kreditorit është në kundërshtim me rendin juridik dhe moralin shoqëror ngase debitori është faturuar pa bazë. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm. Ndërsa, ka shtuar se nuk qëndrojnë asnjëra na pretendimet e parashtruara në prapësim dhe se debitori nuk ka ofruar prova në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së. Në fund, ka theksuar se urdhri përmbartimor është nxjerr në bazë të vendimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm i cili dokument përbën titull ekzekutiv. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prizren, Dega Suharekë, me Aktvendimin PP.nr. 168/2019, të datës 15.04.2021, ka aprovuar propozimin e debitorit për kthim në gjendje të mëparshme, ndërsa prapësimin e debitorit e ka aprovuar pjesërisht duke anuluar urdhrin përmbartimor për pjesën e detyrimit që rrjedhë nga viti 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014 dhe 2015, dhe procedurën në këtë pjesë e ka përfunduar. Në pikën III të dispozitivit të aktvendimit, është refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit përtej vendosjes si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktvendimit, ashtu që

për pjesën e detyrimi nga viti 2016 në shumë prej EUR 532, urdhri përmbarimor P.nr. 1024/19, i datës 17.6.2019 është lënë në fuqi.

Ndaj këtij aktvendimi, kreditori ka paraqitur ankesë, ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, me Aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr. 444/22, të datës 27.09.2023, e ka aprovuar ankesën e kreditorit si të bazuar, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, Dega Suharekë, PP.nr. 168/2019, të datës 15.04.2021 e ka anuluar dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale. Në arsyetimin e këtij aktvendimi, gjykata e shkallës së dytë ka udhëzuar që në rivendosje gjykata e shkallës së parë paraprakisht të shqyrtoj afatshmërinë e propozimit të debitorit për kthim në gjendje të mëparshme e më pastaj të vlerësoj nëse dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit.

Në rivendosje, gjykata duke i marr për bazë edhe sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë të dhëna në Aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr. 444/22, të datës 27.09.2023, ka shqyrtuar afatshmërinë e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 130.2 të LPK-së, me të cilën është përcaktuar se *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkak i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”* dhe paragrafi 3 të të njëjtit nen *“Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme”*, vlerësoi se kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme është e afatshme. Kjo, pasi që përmbaruesi privat ka dorëzuar propozimin për përmbarim tek personi F.M. me datë 25.06.2019, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka qenë 7 ditë përkatësisht deri më datë 02.07.2019, datë kjo e mosveprimit, ndërsa kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme është paraqitur me datë 18.07.2019, pra brenda afati të përcaktuar ligjor.

Nisur nga kjo gjendje, bazuar në dispozitën e nenit 68.2 të LPP-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë”*, dhe nenet 17 dhe 18 të LPP-së, lidhur me nenin 129.1 të LPK-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”*, gjykata vendosi si pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht vendimin mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi Nr. 6161, i datës 01.08.2017, mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin është i plotfuqishëm, ndërsa mban vulën e ekzekutueshmërisë së datës 05.09.2017, dhe rrjedhimisht i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”.*

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit në parashkrimin e kërkesës së kreditorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara, ngase nga shkresat e lëndës rezultoi se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbartimor është bërë i ekzekutueshëm 05.09.2017, ndërsa propozimi për përmbartim nga ana e kreditorit është ushtruar me datë 14.06.2019, ashtu që nuk ka kaluar afati prej më tepër se 5 vite ashtu siç përcaktohet me nenin 144.3 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, sipas së cilës dispozitë *“Akti administrativ nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe*

nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi, apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutimin”.

Poashtu, gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit se për të njejtën çështje janë në zhvillim e sipër disa procedura gjyqësore rrethanë kjo për të cilën gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara, pasi që procedura kontestimore cila është në zhvillim e sipër pranë Gjykatës Themelore në Prizren ka për objekt kontesti borxhin në emër të shfrytëzimi të brezit rrugor për periudhën prej vitit 2001-2012, ndërsa objekt trajtimi në këtë procedurë përmbarimore është pagesa e detyrimit sipas Vendimit nr. 6161, të datës 01.08.2017, të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor dhe rrjedhimisht nuk ka identitet objektiv mes procedurave tjera në zhvillim dhe kësaj procedure përmbarimore, andaj edhe nuk ekziston gjyqvarësia në kuptim të nenit 262 të LPK-së.

Tutje, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se çështja për të cilën kjo procedurë është në zhvillim e sipër përbën çështje të gjykuar, rrethanë kjo poashtu për të cilën gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, mirëpo të njëjtat i gjeti si të paqëndrueshme nga fakti se Urdhri Përmbarimor P.nr. 297/18, i datës 07.02.2018, i shfuqizuar me Aktvendimin i Gjykatës Themelore në Prizren, Dega Suharekë PP.nr. 17/16, i datës 15.05.2018, është lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm dhe jo mbi bazën e titullit përmbarimor –e vendimit nr. 01-6161, i datës 01.08.2017 i cili është objekt përmbarimi në këtë çështje dhe rrjedhimisht nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet e tjera të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat më tepër paraqesin bazë ankimore ndaj aktvendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri dhe nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në procedurë përmbarimore, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 27 të LPP-së.

Rrjedhimisht, gjykata gjen se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2182/23, datë 07.06.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.